

# ***KUVENDI I KOSOVËS***

*Prishtinë, 15. maj 2003*

Duke konfirmuar fitoren në Luftën Çlirimtare të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, të mbështetur nga NATO, e udhëhequr nga SHBA-të dhe aleatet e saj;

Duke rikonfirmuar vendosmërinë e qytetarëve të Kosovës për Kosovën shtet Demokratik të Pavarur dhe Sovran;

Duke konsideruar se vlerat e luftës Çlirimtare janë vlera të gjithë popullit të Kosovës dhe vlera të pranuar nga faktori ndërkombëtar;

Kuvendi i Kosovës, duke shprehur vullnetin e qytetarëve, miraton këtë:

## **REZOLUTË PËR LUFTËN ÇLIRIMTARE TË POPULLIT TË KOSOVËS PËR LIRI DHE PAVARËSI**

**I.** Lufta e popullit të Kosovës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, në të gjitha fazat dhe format e zhvillimit të vet: lufta politike, rezistenca paqësore dhe lufta e armatosur e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ka qenë luftë e drejtë për lirinë e vendit dhe për një shoqëri moderne e demokratike;

**II.** Rezistenca paqësore dhe lufta politike e konstitucionale e shprehur me Kushtetutë dhe Referendum ka përcaktuar vullnetin e qytetarëve të Kosovës për pavarësi dhe demokraci;

**III.** Lufta e armatosur e qytetarëve të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ka qenë luftë e drejtë dhe e pastër për çlirimin e Kosovës, luftë kundër forcave ushtarake, policore e paramilitare serbe;

**IV.** Lufta e NATO-s, e udhëhequr nga SHBA, ka qenë luftë kundër dhunës dhe gjenocidit të pushtetit serb në Kosovë dhe për shpëtimin e çlirimin e popullit të Kosovës;

**V.** Lufta politike dhe e armatosur për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës është në themelet e politikave që Kosova të bëhet shoqëri moderne, e lirë e demokratike, për të gjithë qytetarët, pa dallim bindjeje politike, besimi, përkatësie etnike apo racore;

**VI.** Kuvendi i Kosovës e udhëzon Qeverinë e Kosovës, që në një kohë sa më të shpejtë, të përgatis ligjet, me të cilat do të rregullohet statusi i luftëtarit për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Këtë Rezolutë e mbështesin :

Grupi Parlamentar i LDK-së z. Sabri Hamiti \_\_\_\_\_  
Grupi Parlamentar i PDK-së z. Arsim Bajrami \_\_\_\_\_  
Grupi Parlamentar i AAK-së z. Bujar Dugolli dhe \_\_\_\_\_  
Grupi Parlamentar të Tjerët z. Faik Merolli \_\_\_\_\_

